



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ALBPETROL" SHA

Nr. 4435 Prot.

Patos, më 22 . 08 . 2025

URDHËR

Nr. 354 , datë 22 . 08 . 2025

PËR

SHPALLJEN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS NË SHOQËRINË "ALBPETROL" SH.A

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04. 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, nenit 18 të Statutit të Shoqërisë "Albpetrol" Sh.A, rregullores "Për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e shoqërisë "Albpetrol" Sh.A", miratuar me vendimin nr. 14, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 6.11.2024, rregullores "Mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve në shoqërinë Albpetrol" Sh.A", miratuar me vendimin nr. 15, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 6.11.2024, dhe Kontratës Kolektive të Punës, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e vendeve të lira të punës në shoqërinë "Albpetrol" sh.a.", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë procesverbalin përmbledhës, të cilin, bashkë me dokumentet shoqëruese dhe dosjet e kandidatëve aplikues, t'ia paraqesë me memo Administratorit të shoqërisë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, për zbatimin e këtij urdhri, dhe Drejtori i Departamentit Administrativ, për ndjekjen e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATOR

Eltar DEDA



Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rr. "Fier-Patos", Km. 7, Patos
T +3553813662 F +35534704415 www.albpetrol.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE
E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, nenit 18 të Statutit të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, në zbatim të vendimit nr.16, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 19.12.2024, “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol Sh.A., 2025”, dhe të Rregullores “Mbi marrëdhëniet e punës të punonjësve në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A”, miratuar me vendimin nr.15, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 6.11.2024, shoqëria “Albpetrol” Sh.A shpall vendet e lira të punës në specialitetet për qendrat e shoqërisë, si më poshtë:

Nr.	Specialiteti	Kuotat	Qendra e Furnizimit dhe Transportit	Qendra e Prodhimit të Naftës		
				Fier	Kuçovë	Gorisht
1	Xhenerik / Saldator	1				1
2	Saldator	2		1	1	
3	Motorist/Saldator	1			1	
4	Drejtues mjeti autovinç	1	1			
5	Drejtues i mjeteve teknologjike	1	1			

Afati për dorëzimin e dokumenteve **31.8.2025**.

KRITERET PËR APLIKIM

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret si vijon:

- Të ketë, si rregull, shtetësinë shqiptare;
- Të jetë fizikisht i aftë për të punuar dhe për të përmbushur detyrat që përmban pozicioni i punës;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- Të respektojë dhe zbatojë legjislacionin, si dhe dispozitat e tjera të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Të mos ketë marrë masë disiplinore të largimit nga puna, nga subjektet ku ka qenë i punësuar, për vepra penale dhe/ose sjellje që tejkalojnë qëndrimin shoqëror moral, si dhe të mos jetë dënuar nga gjykata me një vendim penal të formës së prerë, për krime kundër autoritetit të shtetit, ose vepra penale kundër veprimtarive të kryera

- ndaj punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik etj.
- f. Të zotërojë document/certifikatë të formimit/trajnimit në specialitetin për të cilin aplikon, sipas shpalljes.
 - g. Të ketë eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vjet në profesion.
 - h. Për specialitetet 1, 2 dhe 3, aplikanti të jetë i pajisur me certifikatë për punimet/saldimet e enëve nën presion.
 - i. Për specialitetet 4 dhe 5, aplikanti të jetë i pajisur me leje drejtimi të kategorive B, C, D, BE, CE, DE.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Aplikanti duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

- a. Kërkesë me shkrim drejtuar shoqërisë “Albpetrol” Sh.A në të cilën të përcaktohet specialiteti për të cilin aplikon;
- b. Jetëshkrim (CV);
- c. Kopje të letërnjoftimit (ID);
- d. Kopje të dëftesës së shkollës së mesme;
- e. Kopje të librezës së punës apo dokument tjetër që tregon eksperiencën e punësimit në specialitetin e kërkuar;
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore që tregon se është fizikisht i aftë për të punuar dhe për të përmbushur detyrat që përmban pozicioni i punës në specialitetin e kërkuar;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, sipas formularit bashkëngjitur;
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Shënim: Në rastin e kualifikimit, në përfundim të procedurës, aplikanti paraqet dokumentet e mësipërme të noterizuara dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Dorëzimi i dokumenteve të sipërcituara duhet të bëhet në rrugë postare, në adresën:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.A: Rr. “Fier-Patos”, Km. 7, Patos,
ose pranë Zyrës së Protokollit.

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

FORMULAR VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Patos, _____._____.2025

TË DHËNAT E DEKLARUESIT:

Të dhëna të përgjithshme:	
Emri, Mbiemri	
Atësia / Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Nr. Dokumentit të identifikimit (ID) (kopje ID bashkëlidhur formularit)	
Adresa e vendbanimit aktual në ditën e vetëdeklarimit:	
Lagjja:	
Rruga:	
Ndërtesa Nr.	
Shkalla Nr.	
Apartamenti Nr.	
Bashkia:	
Njësia Administrative:	
Fshati:	
Nr. Celular	
E-mail personal	

DEKLARUESI

Emër Mbiemër / Firmë

Dorëzuar në Patos, më _____._____.2025

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga **Shoqëria "Albpetrol" Sh.A**

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij vetëdeklarimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi administrative e penale sipas ligjit dhe passjell pasoja sipas parashikimeve në Rregulloren e shoqërisë dhe Kontratën Kolektive të Punës.